



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 251, datë 27.10.2020

**“PËR MIRATIMIN E RELACIONIT MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE  
FIGURËS TË KANDIDATES PËR T’U PRANUAR NË PROGRAMIN E FORMIMIT  
FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS,  
NË VITIN AKADEMIK 2020-2021,  
ZNJ. JONIDA ALLUSHI”**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 159, pika 2/a dhe 161, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenit 32, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Seksionit VI dhe Seksionit VII, të Vendimit nr. 171, datë 27.9.2019 “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, si dhe pasi u njoh me Relacionin “Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatës për Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2020-2021, znj. Jonida Allushi”, të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e Relacionit mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatës znj. Jonida Allushi, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidatës për t’u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, në vitin akademik 2020-2021.
3. Të njoftohet për këtë vendim znj. Jonida Allushi dhe Shkolla e Magjistraturës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**



**KRYETAR**

**GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR**

**ALFRED BALLA**

**ANËTAR**

**KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR**

**BUJAR SHESHI**

**ANËTAR**

**NURIHAN SEITI**

**ANËTAR**

**SANDËR BECI**

**ANËTAR**

**VATË STAKA**

**ANËTAR**

**TARTAR BAZAJ**

**ANËTAR**

**ESMERALDA KESHI**